


BURLO

Udhezues i Sherbimeve



Instituti i Shtrimi dhe Kujdesit Shendetesor Nene - Femije me Karakter Pediatrik Shkenzor “**Burlo Garofolo**” – Spital me nivel te larte specializimi ne rang kombetar per shendetin e Graus dhe Femijes.

Prezantim:

Burlo Garofolo është Instituti i Shtrimit dhe Kujdesit shëndetësor nënë - fëmijë me karakter shkencor, njihet si një nga spitalet me nivel të lartë specializimi në rang kombëtar në sektorin pediatrik, në mbrojtjen e amesise dhe kujdesin shëndetësor të gruas. Ndjek, një standard të jashtëzakonshme, si qëllim hulumtimit në fushën biomjekësore dhe në organizimin e shërbimeve shëndetësore, modele të reja të kujdesit dhe transferimit të njohurive, njëkohësisht shtrimin spitalor dhe të kujdesit shëndetësor intensiv.

Siguron ofrimin e shërbimeve diagnostike, kujdesit dhe rehabilitimit për qytetarët e provincës së Triestes, Friuli Venezia Giulia dhe jashtë rajonit, përfshirë edhe shtetasit e huaj.

Është seli e Klinikave dhe Shërbimeve diagnostike Universitare duke respektuar një marrëveshje të veçantë me Universitetin e Triestes, sipas të cilit mund të zhvillohen aktivitete didaktike dhe kërkimore.

VLERAT NGA FRYMEZOHET

I.R.C.C.S "Burlo Garofolo" për sigurimin e shërbimeve shëndetësore bazohet në parimet themelore të :

- **Barazi**
- **Paanese**
- **Vazhdimesi**
- **E drejta e zgjedhjes**
- **Pjesëmarrje**
- **Funksionalitet dhe efektivitet**

Angazhimet e Institutit

Instituti angazhohet për mbrojtjen e të drejtave të përdoruesve të cilëve ju kërkon të respektojnë disa rregulla të përgjithshme me qëllim që të siguroj mbarëvajtjen e aktiviteteve dhe një bashkëjetesën paqësore gjatë qëndrimit në spital.

Njohja e të drejtave

Instituti angazhohet të siguroj të drejtat e fëmijëve dhe familjeve të tyre, grave dhe qytetarëve;

- merr persiper shërbime dhe kujdes shëndetësor me cilësi, në përputhje me kriteret e funksionalitetit dhe efektivitetit;
- vazhdimësi të shërbimeve ;
- drejtësi dhe paanshmëri, duke respektuar ndryshimet pa diskriminim gjinie, race, kombësie, gjuhe, kulture dhe feje;
- respekt për dinjitetin njerëzor gjatë trajtimit, identifikimi vetem me ane të emrit dhe të trajtimi me respekt;
- konfidencialitetin e gjithë informacionit mbi shëndetin dhe të shërbimeve të paguara dhe për respektimin e jetës private gjatë ndërhyrjeve diagnostike dhe trajtimin në përgjithësi;
- siguria dhe mbrojtja kundër rreziqeve të shkaktuara nga mosfunksionimi i pajisjeve dhe shërbimeve të ofruara;
- për të marrë informacion të qartë, të thjeshtë, të plotë dhe të kuptueshem mbi shërbimet e ofruara, mbi sëmundjen dhe trajtimin, mundësinë e kerkimeve dhe trajtimeve alternative, edhe pse të ndjekura në struktura të tjera.
- për të dhënë ose jo aprovimin, të mireinformuar mbi kujdesin, rreziqet e pasojat e mundshme para se të fillohet ndërhyrja e propozuara nga personeli

shëndetësor; per te dhene ose jo aprovimin per aktivitet e huluntimit dhe trajnimeve;

- mundesi zgjedhje midis strukturave te ndryshme te cilat ofrojne te njejtin sherbim
- mundesi per te paraqitur ankesa dhe raporte, të bëhen sugjerime dhe lavdërime dhe te kete mundesi te marret pergjigje pas shqyrtimit te tyre ne zyrat perkatese
- pjesëmarrja në procesin e kujdesit dhe përmirësimit të cilësisë së veprimtarisë shëndetësore
- mundesi informimi mbi te dhënat shëndetësore që lidhen me të, te cilat duhet të jenë të qarta, të lexueshme dhe të plotë;
- te marri kujdesin shendetesos pa ju prishur "normaliteti" aq sa është e mundur, ritmet e jetës, zakonet dhe marrëdhëniet shoqërore dhe familjare.

... kujtojmë “detyrimet” ndaj Institutit.

- sjellje të përgjegjshme duke respektuar dhe mirëkuptuar të drejtave dhe nevojave e të tjerëve;
- te respektohet puna dhe profesionalizmi i operatorëve dhe të bashkepunoj me stafin mjekësor, një parakusht për zbatimin e një programi të duhur klinik te sherbimit mjekesor ;
- te respektohen të gjitha mjediset, pajisjet, objektet shëndetësore dhe orendi të pranishëm në strukturat shëndetësore;
- te respektohet orari dhe organizimi shendetesor me qellim zhvillim te rregullt te aktiviteteve;
- respektohen kufizimet ;
- te respektohet qetesia per të shmanguar shqetesime te pacienteve gjate dites dhe nates; te kufizohen vizita për të shmanguar grupime në departamente jashtë orëve

perkates, te fiken telefonat celularët dhe të moderohet volumi i TV, CD, etj ...;

- mos pihet duhan në zone.
- mos largim nga departamentet / shërbimet pa lajmëruar stafin

KONTAKTE TELEFONIKE

Departamenti i Pediatriisë

STRUKTURAT	TELEFON Day Hospital	TELEFON Degenze
Klinika Pediatrike	040 3785 271	040 3785 353
Endokrinologji, diabeti dhe auxologji	040 3785 271	040 3785 353
Gastroenterologji dhe të ushqyerit klinike	040 3785 397	040 3785 353
Alergji, dermatologji dhe trajtimin e astmës	040 3785 222	040 3785 353
Reumatologji pediatrike	040 3785 263	040 3785 353
Sëmundjet e rralla metabolike	040 3785 283	040 3785 353
Onko-hematologjisë pediatrike / transplantimi i palcës kockore	040 3785 309	040 3785 276 040 3785 561
Nero psikiatria pediatrike	040 3785 378	040 3785 353
Audiologjia ORL Kirurgjia dhe Urologjia Pediatrike, Okulisti dhe Strabologia, Odontostomatologjia Pediatrike, Ortopedia Pediatrike	040 3785 508	040 3785 354
Urgjenca pediatrike		040 3785 333
Qendra rajonale fshikëz neurologjike	040 3785 442	040 3785 354
Anestezia dhe Rianimacioni		040 3785 238
Kardiologjia	040 3785 248	











Zona Nene – i Porsalindur

STRUKTURA	TELEFON Day Hospital	TELEFON Shtrimi
Obstetrikë dhe gjinekologji	Gjinekologjia 040 3785 458	Gjinekologjia 040 3785 384
Patologjia Obstetrike	Obstetria 040 3785 300	Obstetria 040 3785 319
Neonatologjisë dhe kujdesi neonatal intensiv	040 3785 439	040 3785 371
Dhoma cerdhe		040 3785 346
Diagnostikimi Ekografik Prenatal dhe Gjinekologjia (Ambulator)	040 3785 247	
Riprodhimi mjekesor i asistuar (Ambulator)	040 3785 566	

Sherbime te tjera

STRUKTURA	TELEFON
Radiologjia Pediatrike	040 3785 363
Sherbimi transfuzional	040 3785 274
URP Zyra e mardhenieve me pubikun	040 3785 461
Arkiv kartela klinike – terheqja e rezultateve	040 3785 468
Qendra unike e prenotimeve (CUP)	040 3785 629

Uniformat tona

	<p>BARDHE Mjek, Farmacist, Psikologe</p> <p>Stafi drejtues dhe punonjes social. (këmisha me xhep me ngjyra, sipas profilit perkates)</p>	
	<p>E BARDHE ME JAKE TE GJELBER Praktikante , bursiste e stazhiste</p> <p>GJELBER Mjek Reanimatore</p>	
	<p>E GJELBER UJI Infermiere, infermiere pedatrik</p> <p>SALMON Obstetre mami</p>	
	<p>E KALTER Stafi teknik radiologjise dhe laboratore Zona teknike i rehabilitimit</p> <p>E BARDHE E BLU Fizioterapia e frymemarrjes e FKT</p>	
	<p>E verdhe e zbehte Punonjes te kujdesit higjenik Infermiere te pergjithshem i (jake me ngjyre me te erret)</p> <p>BLU Persoleli ndihmes OTA</p>	

Me makine

Merr autostraden A4 Venezia -Trieste, pasi kalon stacionin e pagesese autostradale Duino-Lisert vazhdohen me superstraden duke ndjekur shenjen rrugore “Ospedale Burlo Garofolo”(rreth 25 km).

Shpitali ka ne brendesi te territorit pothuajse 50 vende parkimi me qellim perdorim publike (5 nga te cilet jane te rezervuara per personat me aftesi te kufizuar).

Nga ora 14.00 deri ne 07.00 parkimi i brendshem i punonjesve i cili ndodhet afer daljes, hapet dhe per visitoret.

Per fat te keq zona qe e rrethon Spitalin nuk ofron shume mundesi parkimi.

Me avion

Aeroporti me i afert gjendet ne Ronchi dei Legionari: mund te mberrini ne Trieste duke marre autobusin numer 51 i cili niset cdo 30 minuta, ju sjell ne qytet per 50 minuta. Stacioni kryesor gjendet ne Autostazionin e Triestes, perbri stacionit te Trenit ne Piazza della Libertà.

Me tren

Pasi te mberrini ne Stacionin Qendror te Triestes ne Piazza della Libertà, mund te arrini ne Spital me autobus ose me taksi.

Autobuzat

Per te mberritur ne Spital nuk ka nje linje te vetme autobuzi por keshillohet qe nga Piazza della Libertà te shkohet ne Piazza Goldoni ku mund te merret linja 1, me pas te ndryshohet stacioni i arobuzit para tunelit ku mund te merret linjen 10 qe mund te bej te mundur mberritjen ne Burlo.

Eshte e rendesishme qe kur te hipni ne autobus te jeni te paisur me bilete te cilen mund ta blini zakonisht ne pikat e shitjes se gazetave.

Me taksi

Ne hyren anesore te Stacionit Qendror apo dhe perpara Autostazione gjendet sherbimi taksi (nese nuk shihni makinat taksi mund te telefonon Radio Taksi 040-307730 ose Taxi Alabarda 040- 390039).



MUNDESI PRENOTIMI

Vizita dhe shërbime te specializuara ne ambulator

Dokumentat e nevojshem

Për të bërë një prenotim, me telefon, personalisht, ose nëpërmjet internetit, është e nevojshme të keni me vete kartelen shëndetësore gjithashtu dhe receten e mjekut të familjes, sepse procedurat administrative kërkojnë futjen e barkodit në kerkese;

Kush mund të bëjë prenotim

Cdo person i interesuar mjaft të jete i paisur me dokumentat e nevojshem

Si bëhet prenotimi

- prenotimi bëhet në sportelet e CUP të Burlo, në hyrjen qendrore në katin perdhese, nga ora 7.45 deri në 19.20;
- Prane sporteleve CUP në ambulare nga ora 11.30 deri në 13.20;
- Prane të gjitha sporteleve CUP të Spitalit Universitar dhe ambulancave të Intuzionit të shërbimit shëndetësor n. 1 të Triestes (CUP);
- Prane farmacive me kontrate;
- Duke telefonuar numrin e vetëm Call Center shëndeti dhe shoqëria ☎0434 223522, nga e hëna në të premte , nga 7.30 deri 18.00; të shtunën nga 08.00 deri 12.00;
- Nëpërmjet internetit në adresën elektronike e Burlos www.burlo.trieste.it (prenotime on-line); në prenotimi me ditën dhe orën e takimit. Në këtë rast konfirmimi me ditën dhe orën e takimit vjen brenda 72 orësh Në momentin e prenotimit personi duhet të paraqesi receten e mjekëve kurues.

Instituti merr përsipër të komunikojë sa më shpejt ndryshime të mundshme të takimeve; keshillon të komunikohen në kohë anullimet, për të mundësuar efikasitetin në funksionimin e shërbimit shëndetësor.

Pacientët pa recetë, por që besojnë se kanë nevojë për një vizite obstetrike-gjinekologjike urgjente mund të shkojnë në sallën e shtrimit obstetrik-gjinekologjik shkalla D kati i parë, ngjitur me sallën e lindjes.

Shërbimet e ofruara nga ambulatori gjinekologji-obstetrik, duhet të bëjnë pagesën e shumës që parashikohet nga nomenklatura e tarifës.

Duhet theksuar se 'IRCCS Burlo Garofolo nuk ka mundësi për shërbim urgjence për të rritur.

Për të përfituar shërbimet e ofruara nga specialistët private të spitalit Burlo, duhet të identifikohet paraprakisht emri i profesionistit. Ky shërbim ofrohet me parapagesë, pa qene e nevojshme receta e mjekut;

Privatesia

Instituti është i angazhuar të sigurojë të drejtën e fëmijëve dhe familjeve të tyre, grave dhe qytetarëve për konfidencialitetin e të gjithë informacionit mbi shëndetin dhe të shumëve të paguara dhe për respektimin e privatësisë gjatë ndërhyrjeve diagnostikuese dhe trajtimet në përgjithësi.

Përpunimi i të dhënave të ndjeshme personale kryhet për qëllime të kujdesit dhe për qëllime të hulumtimit dhe mësimdhënies. Përpunimi i të dhënave është bërë me ose pa përdorimin e mjeteve elektronike. Të gjithë operatorët që mund të hyjnë në sisteme të kompjuterizuara janë të identifikuar, mbahen sekret por që janë të autorizuar për trajtimin e tyre .

SHOQERIMI I MINORENIT

Vizita e parë dhe sherbime te vecanta në para-shtrim.

Ne vizita e parë lejohet si rregull, prania vetem e njerit prej prinderve, ose përfaqësuesit ligjor, i cili duhet të:

1. te vetë-vërtetojë me shkrim të drejtave të tyre prindërore (vlefshmëria vjetore);
2. japë pëlqimin me shkrim për sherbimin e ofruar, për përdorimin e të dhënave personale dhe të ndjeshme, transferimin e informacionit tek palë të treta (pediatri, etj) (vlefshmëria vjetore);
3. autorizoj me shkrim delegimin e dikujt tjetër për shoqërimin e fëmijës ne vazhdimesi te trajtimit (vlefshmërinë vjetore);
4. autorizojë me shkrim pjesmarrje të pavarur të fëmijës mbi moshën 16 vjet për përfitimet e sherbimeve te parashikuara ne kapitullin "sherbime dytesore vijuese" (vlefshmëri vjetore);
5. jep me shkrim pëlqimin per raste te vecanta invazive (vlefshmërisë kontekstuale)

Ka disa kufizime dhe përjashtime te cilat vleresohen sipas rastit

SHERBIME RADIOLOGJIKE

Dokumentet qe jane te nevojshme

Për te prenotuar, si personalisht ashtu dhe me telefon, ju duhet të jetë në posedim të kartës europiane të sigurimit shëndetësor dhe recetën e mjekut, sepse procedurat administrative kërkojnë futjen e kodit bar ne kërkesës.

Diten qe do te kryhet visita mund te merrni me vehre dokumente te meparsheme qe kane te bejne me analizen e kerkuar.

Kush mund te bej prenotimin

Personi i interesuar ose dhe dikush tjetër mjaft te jete i paisur me dokumentacionin e nevojshem.

Si prenotohet vizita radiologjike:

- **ne moshe pediatrike**

- per analizat si rezonanza magnetike, tomografia asiale e kompjuterizuar, egzaminimet radiologjike qe parashikojne nje lloj parapergatitje(*) si dhe ekografia eshte e nevojshme ti drejtoheni sekretarise se Radiologjise duke telefonur nr 040 3785 363 nga e hena ne te premte nga ora 7.30 deri me 13.30 (vetem te marten nga ora 9.30 deri ne 13.30)
- Per egzaminimet radiologjike te cilat nuk kane nevojje per parapergati (*)eshte e parashikuar HYRJA E MENJEHERESHME nga e hena ne te premte nga ora 7.30 alderi me 13.30 (vetem te marten nga ora 9.30 deri me 13.30) prane sekretarise se S.C. Radiologia – Shkalla B – kati i pare.

(*) Me parapergatitje nenkuptohen rastet kur kemi te bejme me: esell, pastrimit klizmë, analizat e gjakut, pezullimin e mundshëm të terapive të vazhdueshme.

- **Ne moshe te rritur:**

Drejtoheni:

- ne sportelet CUP ne Burlo, prane hyrjes qendrore ne katin perdhes. Nga e hena ne te premte nga ora 7.45 ne 19.20
- Ne sportelet CUP te Institutit Spitalor-Universitar si dhe ne Ambulatoret e sherbimit shendetesor n. 1 te Triestes (CUP);

Ose me telefon:

- Permes Call Center 0434 223522, nga e hena ne te premte nga ora 7.30 deri ne 18.00 dhe te shtunen nga ora 08.00 ne 12.00.
-

P.S Ne rast shtatezanie apo dyshim per shtatezani njoftohet mjeku ose personeli i radiologjise.

Si mund te prenotohen analizat e laboratorit

Nuk kerkoket prenotimi per te kryer analizat e laboratoriti, pervec disa analizave per percaktimin e gjenetikes (cariotipi) (prenotimi behet duke qene personi prezent ose ne internet)

Kush mund ti kryej analizat e laboratorit?

Ju garantohet ky sherbim grupmoshes nga 0-18 vjec, grave shtatezane, dhe sherbimeve te tjera qe vijne nga labororet e analizave te vete Spitalit.

Cilat dokumenta jane te nevojshme per te ndjekur analizat

Eshte e nevojshme te keni librezen shendetesore dhe receten e mjekut kurues, sepse procedurat administrative kerkojne hyrjen e kodit te recetes.

Kur kryhen analizat

Analizat e laboratorit mund te kryhen nga e hena deri te premten nga ora 07:30 deri ne oren 10:00

Si kryhen analizat

- Hyhet direkt ne sportelet CUP te Qendres se Kampioneve te gjakut, ne katin e pare te nderteses Ambulatoriale, per proceduren e pranimit dhe pageses nqs duhet.
- Me pas analizat kryhen ne qendren e kampioneve te gjakut.
- Femijet te moshes nga 0 deri ne 14 vjec kane perparesine, nuk marrin numrin per te eleminuar rradhen dhe kane perparesine ne sportelin e pare te lire.

Te miturit nen 16 vjec duhet gjithmone te jene te shoqeruar nga kush ka ushtrimin e autoritetit prinderor ose te rritur te tjere me kusht qe te kene autorizimin .

Ne fashen e moshes midis 16 dhe 18 vjec, analizat kryen edhe nqs minoreni nuk eshte i shoqeruar nga nje i rritur, por ne kete rast pergjigjia e analizave ju dergohen me poste prinderve.

PAGESAT

Kur kryhen pagesat ?

Pagesa kryhet ne sportelet e shërbimeve ambulatorë. Vetëm në disa raste të veçanta mund të bëhet më vonë, sipas të dhenave të marra në kohën e rezervimeve.

Ku te kryeni pagesat

- Ne sportelet CUP, në sallën qendrore në katin e parë, nga e hëna deri të premten, nga 7,45 në 19,20 prane te cilit kryhen gjithashtu pagesat e shërbimeve private.
- Ne sportelet CUP te Institutit Spitalor-Universitar si dhe ne Ambulatoret e shërbimit shëndetësor n. 1 te Triestes (CUP);
- On line ne adresen elektronike www.burlo.trieste.it
- Ne raste te vecanta pagesa mund te kryhet nepermjet bonifikimit bankar sipas udhësimeve te personelit.

Si te kryhen pagesat

Mund te perdoren te holla kesh ose karta krediti.

TERHEQJA E REZULTATEVE

Si te terheqesh rezultatet e laboratore dhe ne radiologji?

Cfare dokumentash nevojiten

Per te bere terheqjen e rezultateve eshte e nevojshme te paraqitesh nje dokument identifikues

Kush mund ti terheqi?

I interesuari ose nje i rritur tjetër i deleguar
e vlefshme nqs ka nje autorizim me shkrim dhe nje kopje te dokumentit te atij qe do terheqi.

Ne rast se eshte minoren, rezultati do te terhiqet nga ai i cili ka autorizimin e autoritetit prinderor

Ku mund te terhiqen rezultatet?


Prane sherbimit informativ mund te terhiqen rezultatet e :

- Analizat radiologjike (nga e hena ne te premte, nga ora 7.30 ne 19.30);
- Analizat e laboratorit (nga e hena ne te premte, nga ora 14.00 alle 19.00);

Ne momentin e prenotimit mund te kerkohet dergim i rezultatit te analizave me poste ne adresen e shtepise.

Sipas legjislacionit aktual (neni 18 paragrafi 4 Ligji 412/1991), mosterheqja e referteve brenda 30 ditëve sjell pagesen e koston se plote te sherbimit.

Harta



Disa keshilla/informazione te vlefshme per shtrimin ne spital

Cilat dokumente jane te nevojshme per shtrimin:

- libreza shendetesore;
- dokument identifikues;
- kodi fiskal;
- dokumentacionin klinik qe mund të keni (raportet mjekësore, analiza laboratorike, të dhënat mjekësore të shtrimeve te mëparshme, etj).

• Recetat mjekesore per terapite qe ndjek ose ato te fundit me treguesin e ilaceve qe keni perdorur.



Cfare sendesh personale sillen nga shtepia:

- te brendshme, pizhame ose kemishe nate, rrobdishan, pantofla, sende personale, peshqire dhe te gjithcka tjeter qe nevojitet per higjenen personale;
- veshje te pershtatshme me jeten ne spital (per shoqeruesin qe rrin ne spital);

• veshje te pershtatshme per jeten ne spital (per personin qe shoqeron te miturin);



• vetem nje sasi te vogel lekesh per nevojat thelbesore.

Eshte e pakeshillueshme te mbash me vete objekte te cmuara dhe rekomandohet te mos lihen te pambikqyrur asnje send me vlere.

Gjate shtrimit pazientet e vegjel mund te mbajne me vete lodrat dhe

sendet e tyre personale, me kusht që ato nuk paraqesin një pengesë për programin e kurimit të tyre.

Orari i vizitave të afërmeve dhe familjareve:



Shtrimi Pediatrik: nga ora 14.00 deri në 19.00
Shtrimi Obstetrik e Gjinekologjik: nga ora 14.00 deri në 16.30 dhe nga 19.00 deri në 20.30.
Është rekomanduar që të kufizohen vizitat në spitalin e obstetrikë dhe gjinekologjise në një vizitor dhe respektimi i orarit të takimeve.

Ne repartet e *Rianimaciones*, të *Terapise Intensive Neonatale* dhe të *Ematologjia*, është e nevojshme të kërkohet leje personelit shëndetësor.

Prezenca e një prindi

Prindërit / kujdestarët e fëmijëve mund të rrinë, njëherë njëri njëherë tjetri me fëmijët e tyre ditën dhe natën dhe janë të përfshirë në kujdesin dhe kurimin e tyre. Për prindërit e fëmijëve të pranuar nga jashtë Trieste ka mundësi të qëndrojnë në shtëpi për mysafirë "SHTEPIA IME." Kërkesat duhet të bëhen Kordinatores së Infermierise, e cila aktivizon kërkesën sipas Rregullores. Disponueshmërinë e strehimit është i kufizuar dhe në përgjithësi i është dhënë për rastet ku pritet një shtrim i zgjatur në spital. Prindërit mund të përdorin mensën spitalore me çmim të arsyeshëm, me menyrat e treguara nga personeli i infermierise. Nënata që ushqejnë me gjë kanë të drejtë për ushqim falas. Ky spital është aplikuar për metodën e "ushqimit me gjë" nënata e reja i është dhënë mundësia që të kenë fëmijën pranë tyre për sa kohë që ata e dëshirojnë dhe sa më shpejt të jetë e mundur, janë të përfshirë në kujdesin e të porsalindurit.

Pike ku mund te merrni pije freskuese

Ne hyrjet kryesore te 3 pallateve jane vendosur makina ku mund te blesh kafe, pije, embelsira, dhe ne rast nevoje eshte vendosur dhe ne j makine per te thyer leket .

Intervista me mjekët

Eshtë gjithmonë e mundur për anëtarët e familjes të kenë informacion mbi shëndetin e pacientëve të referuar nga mjeku ose duke i kërkuar një takim me shefin, përmes Kordinatorit Infermierisë, që i nënshtrohet rregullave të përcaktuara nga ligji mbi privatesine.

Vizita mjekësore dhe diagnostikuese

Normalisht kryen gjatë mëngjesit dhe gjatë vizitës atje mund të jenë prezent studentët dhe mjekët në specializim qe frekuentojne repartet e Institutit.

Legjislacioni parashikon që para se ti nënshtrohet analizave diagnostikuese dhe ndërhyrjeve terapeutike, pacienti duhet te informohet ne menyre te qarte, dhe te japi aprovimin me shkrim.

Në rastin e fëmijëve nën 18 vjeç aprovimin duhet te jepet nga të dy prindërit.

Dalja nga spitali

Ne momentin e daljes leshohet “nje leter daljeje”, relacioni klinik per mjekun kurues. Nqs relacioni nuk dorezohet

menjehere, niset me poste me shpenzimet e Spitalit brenda 15 diteve. Kthimi ne shtepi parashikohet me mjetet e tyre. Kopia e karteles klinike mund te kerkohej prane Sherbimit te informacionit ne atrion qendrore te IRCCS.

SHERBIME TE TJERA

Sherbimi Social

Shërbimi Social punon në sinergji me të gjitha strukturat prezente brenda IRCCS. Metodologjia e veprimit është e përqëndruar në procesin e ndihmes që synon ne mbështetjen e grave, fëmijëve dhe prindërve të tyre gjatë qëndrimit të tyre në spital duke i ofruar mbështetje për të menjanuar situatat shqetesuese, duke bashkepunuar me shërbimet sociale dhe shëndetësore sociale territorialisht eksperte .Asistenca nga Shërbimit Social aktivizohen nga personeli shendetesor edhe me kerkese te personave te interesuar.

Sherbimi Fetar

Instituti ndermerr persa te jete e mundur te permbushe kerkesat per asistence fetare duke siguruar kontaktin meperfaqesues te ndryshem fetar. Per te kontaktuar nje perfaqesues te feve te tjera kerkesa i behet Koordinatorit Infermieristik.

Ndërmjetësimi kulturor

Për të lehtësuar hyrjen e të huajve drejt shërbimeve shëndetësore, Instituti ka filluar një bashkëpunim me një shoqate qe zhvillon aktivitete të ndërmjetësimit gjuhësor dhe kulturor.

Ndërmjetësi kulturor është një person i kualifikuar, me një formim të veçantë, e cila është e nevojshme për të ruajtur sekretin profesional. Misioni i tij është të nxisë komunikimin me mjekun tuaj, me operatorët shendetesore dhe me te gjithë profesionistët e Spitalit.

Vecanerisht per:

- Te shpjeguar problemin tuaj shendetesor

- Te kuptuar cila eshte diagnoza juaj
- Te kuptuar mire kuren qe ju pershkruajne
- Te kuptuar cfare duhet te beni kur te dilni nga spitali

Ne rast nevojje ky sherbim eshte falas vetem nqs aktivizohet nga Koordinatori Infermieristik ose nga mjeke te strukturave shendetesore.

Cka ofron spitali:

Njerëzit të cilët nuk janë të regjistruar në Sistemin Shëndetësor Kombëtar dhe kanë nevojë për kujdes mjekësor mund të kërkojë të gjitha informacionin e kërkuar në Drejtorinë CUP i cili ndjek procedurat administrative te nevojshem per perfitimin e sherbimeve.

Eshte e keshillueshme qe para se te shkoni ne departamente e nevojshme ti drejtoheni Drejtorise CUP me te gjitha dokumentat e nevojshem identifikues.

Shkolla ne spital:

Ne IRCCS Burlo Garofolo, ne spital ka mundesi shkollimi të shkallës së parë dhe të dytë ku përmbushen aktivitet edukative dhe didaktike, sigurojnë ndërlidhje me shkollat e përkatësisë dhe të drejtës për arsim të minorenit te shtruar. duke qene e drejte e te gjitheve shkolla ne spital është veçanërisht e rëndësishme për pacientët afatgjatë dhe për ata qe shtrohen shpesh.

Ky lloj sherbimi mund të kerkohet duke ju drejtuar shkollave, stafit të departamentit apo mësuesve drejtpërdrejt ose me postë elektronike, duke përdorur adresat te cilat gjenden në fletëpalosje e afishuara në reparte

Zyra për Marrëdhënje me Publikun (URP)

Zyra për Marrëdhënie me Publikun merret me sherbimin e informacionit te drejtuar qytetareve,bashkepunon me shoqatat vullnetare, mbledh dhe analizon raportet dhe ankesave, është

hartuar për të monitoruar nivelin e kënaqshmërisë së qytetareve.

Qytetaret , organet vullnetare të akredituar prane Rajonit,mund te paraqesin raportin e / ankesën brenda 15 ditëve nga koha qe

ata janë të vetëdijshëm për veprimet apo sjelljet me të cilat kufizohen përdorshmëria e shërbimeve shëndetësore te dhena nga 'Instituti.

Ankesat mund te paraqiten ne oraret e meposhtme

- personalisht prane l'U.R.P. ne Katin Perdhes te Nderteses Ambulatori Piano Terra nga e hena deri te premten nga ora 10.00 deri ne oren 12.00 dhe me takim ne mesdite.
- me shkrim nepermjet nje moduli qe gjendet prane Kutise se Ankesave qe ndodhet ne Atrion Qendrore te Institutit.
- me shkrim nepermjet letres te derguar URP prane "Burlo Garofolo" Via dell'Istria 65/1 34137 – TRIESTE ose me fax 040 3785487

Shoqatat vullnetare:

Disa shoqata vullnetare jane aktive ne brendesi te spitalit per paciente me patologji dhe problematike te vecanta.

Informacione ne lidhje me kete mund te jepen nga Kordinatoret e Infermierise dhe nga Zyra e Mardhenieve me Publikun.



5 X MILLE

Me ane te *5 per mille* duke zgjedhur Spitalin Burlo Garofolo mund te kalohet nje pjesë të vogël të taksave pa asnjë barrë shtesë ekonomike. Kontributi do të përdoret për të financuar stazhe dhe kontrata të studiuesve, por edhe për të blerë makineri apo pajisje të nevojshme për të ruajtur dhe për të përmirësuar standardet e përsosmërisë që karakterizojnë shërbimet e ofruara për fëmijët dhe familjet e tyre. Ne momentin e deklarimit te te ardhurave mund ti komunikohet komercialistit ose operatorit CAF qellimin e dhurimit te 5 per mille, thjesht duke firmosur kutine "**financimi per studimet mbi shendetin**" e cila gjendet ne modelet e paraqitura nga Agjencia e Hyrjeve Ekonomike :

modeli integrues CUD

modeli 730/1–bis te ardhura

modeli Unik person fizik

duke shenuar kodin fiskal te **Burlo Garofolo 00124430323**

KONTAKTE TE NEVOJSHME

Centrali

☎ 040 3785 111

Call Center Shendeti social

☎ 0434 223522

Hene /premtë 07.30-18.00

Shtunë 08.00 - 12.00

URP

☎ 040 3785 461

**Nga e hena ne te premtë nga
ora 10.00 deri 12.00**

E mail: urp@burlo.trieste.it

Urgjenca shendetesore

☎ 118

Adresa e postes elektronike

www.burlo.trieste.it

IRCCS Burlo Garofolo

Via dell'Istria, 65/1- 34137 Trieste

Nen kujdesin e Zyres se Mardhenieve me Publikun.

I rinovuar me korrik te 2015